



Lajmëtari informativ i Qytetit të Shkupit

Numër
falas

SHKUPË

| Numër 26 | Viti V | 04.07.2012 |



Unazë në Gjorçe Petrov



Rruga Samoilova



Bulevardi "Mitropolit Teodosij Gologanov"



Unazë në Butel

OFENSIVË NDËRTIMORE PËR SHKUPIN TONË



Rruga Radishanska



Bulevardi "Sveti Kliment Ohridski"



Unazë në Gjorçe Petrov



Rruga Kozle

ZGJEROHET PJESA E DYTË E BULEVARDIT



Punët ndërtimore për zgjerimin e pjesës së dytë të bulevardit “Sveti Kliment Ohridski”, nga kryqëzimi me bulevardin “Partizanski odredi” deri te rruga “Dimitrija Tucoviq” janë në fazën përfundimtare. Në gjatësi 380 metra, kjo rrugë automobilistike do të ketë gjashtë korsi, trotuare të reja dhe gjelbërim të mesëm.

- Qyteti i Shkupit në shtator të vitit të kaluar zgjeroi bulevardin “Sveti Kliment Ohridski”, nga kryqëzimi me rrugën “Mito Haxhivasilev Jasmin” deri te kryqëzimi me bulevardin “Partizanski odredi” në gjatësi 524 metra. Në pjesën e dytë, deri te rruga “Dimitrija Tucoviq”, bulevardi do të zgjerohet me nga një korsi rrugore në të dyja anët, gjë me të cilën do të bëhet me gjashtë korsi. Korsi të reja rrugore do të jenë të gjera 3,5 metra. Pas zgjerimit, asfalti ekzistues i rrugës automobilistike do të gërryhet dhe do të shtrohet me shtresë të re asfalti në

ARDIT "SVETI KLIMENT OHRIDSKI"



sipërfaqe prej 4 000 metra katror. Bordurat përgjatë rrugës automobilistike gjatë punëve ndërtimore do të zëvendësohen plotësisht. Do të formohen edhe trotuare të reja të shtruara me pllaka begatoni, me korsi për këmbësorë dhe biçikleta. Ndërtimi i rrugës së re do të shfrytëzohet për ndërtimin e rrjetit të ri të ujësjellësit Ø 150 dhe Ø 200 milimetra prej tubash hekuri të derdhur përgjatë bulevardit "Sveti Kliment Ohridski" deri te bulevardi "Ilinden". Në pjesën e mesme të bulevardit do të ndërtohet zhardinier në të cilën do të mbillen drurë dekorativë gjetherënës dhe lule. Në këtë projekt ndërtimor voluminoz do të investojmë 30 milion denarë – thotë kryetari i Qytetit të Shkupit Koce Trajanovski.

Në zgjerimin dhe rikonstruksionin e bulevardit "Sveti Kliment Ohridski" – faza e dytë punojnë ekipet ndërtimore të SHA "Granit" Shkup.



„SHKUP“

LAJMËTARI INFORMATIV I
QYTETIT TË SHKUPIT

Numri i parë i lajmëtarit informativ
„Shkupi“ u botua më:
10 dhjetor 2008

Kryeredaktor
Nedelço Krstevski

Redaksia
Seksioni për marrëdhënie me
opinionin

Redaktor i fotografi së
Radomir Jovanoviç

Përkthyes dhe lektor
Vladimir Bogdanovski

OTON QYTETI I SHKUPIT
për botuesin
Kryetari i Qytetit
Koce Trajanovski
Bulevardi Ilindenska p.n.

Telefon
02 3297 255
e-mail adresa
gragjani@skopje.gov.mk
Dizajni/Botol:
Graficki Centar Skopje

PAMJE E RE EDHE PËR PJESËN E DYTË TË RRUGËS “MITROPOLIT TEODOSIJ GOLOGANOV”



Pjesa e dytë e rrugës “Mitropolit Teodosij Gologanov”, nga kryqëzimi me rrugën “Franklin Ruzvelt” deri te kryqëzimi me rrugën “Bratfordska” dhe bulevardit “8.Sepetmври”, deri në fund të kësaj vere do të ketë pamje të re. Në gjatësi prej 1100 metra kjo rrugë automobilistike do të ketë 4 korsi rrugore, trotuare të reja dhe ndriçim.

- Në terren do të bëhet gërmimi, do të shtrohet shtresa e tamponuar dhe sipërfaqja do të asfaltohet. Gjatë konstruksionit të rrugës, do të përfundoheret zëvendësimi i bordurave, dhe do të kryhet edhe mbrojtja e instalimeve nëntokësore (instalimi i ujësjellësit Ø 400 me gjatësi 400 metra dhe tubacioni i gazit Ø 400 me gjatësi 420 metra). Nga të dyja anët e rrugës automobilistike do të formohen trotuare me gjerësi 3,5 metra. Trotuaret do të shtrohen me pllaka begatoni me sipërfaqe 6 500 metra katror. Zgjerimi i rrugës automobilistike “Mitropolit Teodosij Gologanov” në bulevard do të shfrytëzohet për të ndërtuar kanalizimin atmosferik me gjatësi 1 500 metra, me profil 200 dhe 400 milimetra i cili do të lidhet me kolektorin ekzistues. Do të kryhet edhe rikonstruksioni



i kanalizimit ekzistues të ujërave të zeza nën rrugën "Mitropolit Teodosij Gologanov" me gjatësi 20 metra. Punët ndërtimore për rikonstruksionin dhe zgjerimin e pjesës së dytë të rrugës "Mitropolit Teodosij Gologanov" do t'i kryejë firma e ndërtimit „Trans Met DDO“. Qyteti i Shkupit në këtë punë voluminoze do të investojë rreth 47 milion denarë. Punët ndërtimore duhet të përfundojnë për 90 ditë pune. Me këtë punë ndërtimore rruga "Mitropolit Teodosij Gologanov" do të ketë një pamje të re dhe moderne, dhe do të rritet edhe siguria në qarkullimin rrugor. Ky projekt është vetëm një nga vargu i projekteve të suksesshme që Qyteti i Shkupit i realizoi në territorin e komunës së Karposhit – tha kryetari i Qytetit të Shkupit Koce Trajanovski.

Gjatë punëve ndërtimore në pjesën e dytë të rrugës "Mitropolit Teodosij Gologanov" në pjesën e përmendur do të ketë regjim të përkohshëm të qarkullimit rrugor. Qyteti i Shkupit apelon deri te të gjithë pjesëmarrësit në qarkullimin rrugor të respektojnë sinjalizimin dhe të respektojnë regjimin e qarkullimit rrugor të vendosur.

Qyteti i Shkupit vitin e kaluar përfundoi me sukses realizimin e fazës së parë të projektit kapital për zgjerimin e bulevardit "Mitropolit Teodosij Gologanov", në drejtimin nga rruga "Franklin Ruzvelt" deri në rrugën "Kosturski heroj" (një degë) dhe drejt rrugës "Mito Haxhivasilev Jasmin" deri në kthesën në të djathtë drejt rrugës

"Naroden Front" (dega e dytë). Në pjesën ndërmjet rrugëve "Mitropolit Teodosij Gologanov", "Kosturski heroj" dhe "Mito Haxhivasilev Jasmin" (tek kisha katolike) është formuar unazë turbo rrethore, e cila përfaqëson objektin e parë të këtij lloji në Shkup. Përgjatë bulevardit të zgjeruar janë mbjellur 100 drurë.





SË SHPEJTI UNAZË E DYTË NË KOMUNËN GJORÇE PETROV

Unazë së shpejti do të lidhë bulevardin "Partizanski odredi", bulevardin "Makedonska vojska", rrugën "4.Juli" dhe rrugën "Luka Gerov", në komunën Gjorçe Petrov. Qyteti i Shkupit në këtë punë ndërtimore komplekse do të investojë rreth 25 milion denarë.

Sipas projektit, në unazë do të formohen 2 korsi rrugore, me gjerësi 4,5 metra. Para hyrjes në unazë tek bulevardi "Partizanski odredi" do të zgjerohet edhe me një korsi rrugore nga ana e djathtë, kurse përgjatë bulevardit do të ndërtohen trotuare me gjerësi deri në 2,5 metra të cilat do të shtrohen me pllaka begatoni.

Përgjatë bulevardit "Makedonska vojska" dhe rrugëve "Luka Gerov" dhe "4.Juli" do të formohen trotuare nga të dyja anët me gjerësi nga 1,5 deri në 4,5 metra,

të cilat do të shtrohen me pllaka begatoni. Në unazën e re të ndërtuar tek kisha "Shën. Petar dhe Pavle" do të vendoset ndriçim i ri.

Punët ndërtimore do t'i kryejnë ekipet e SHA „Granit“.



UNAZË DO TË ZGJIDHË KAOSIN NË KOMUNËN E BUTELIT

Për të zgjidhur problemet me qarkullimin rrugor me të cilat qytetarët e komunës së Butelit ballafaqohen vite me radhë këtë verë do të ndërtohet unazë ndërmjet rrugëve "Boca Ivanovai" dhe "Aleksandar Urdarevski".

Gjatë kësaj rrugët "Aleksandar Urdarevski" dhe "Cetinska" do të jenë të ndara fizikisht me trotuar.

Në unazën ndërmjet rrugëve "Boca Ivanova" dhe "Aleksandar Urdarevski" do të ketë dy korsi rrugore. Rruga "Aleksandar Urdarevski" pas rikonstruksionit do të ketë dy korsi rrugore, me gjerësi nga 3,5 metra, kurse nga anët e rrugës automobilistike do të ndërtohen trotuare me gjerësi të ndryshme dhe korsi për biçikleta me gjerësi 2,5 metra. Rruga "Boca Ivanova", gjithashtu, do të ketë dy korsi rrugore me gjerësi nga 3,5 metra, trotuare nga të dyja anët me gjerësi 3 metra dhe gjelbërim.

Trotuaret në të dyja rrugët rreth unazës do të shtrohen me pllaka begatoni, me gjatësi të përgjithshme 4 910 metra katror. Në trotuarin ndërmjet rrugëve "Aleksandar Urdarevski" dhe "Cetinska" do të vendosen shtylla metalike të cilat do të



pengojnë kalimin e automjeteve përtej trotuarit.

Ndërtimi i unazës do të shfrytëzohet për rikonstruksionin dhe mbrojtjen e rrjetit ekzistues të ujësjellësit (Φ 300 dhe Φ 400), kurse në një gjatësi prej 127 metrash do të ndërtohet rrjeti i ri ujësjellësi me profil Φ 200. Projekti parashikon edhe ndërtimin e kanalizimit atmosferik në gjatësi 300 metra

(me profil të ndryshueshëm nga Φ 200 deri në Φ 500).

Në ndërtimin e kryqëzimit rrethor ndërmjet rrugëve "Boca Ivanova" dhe "Aleksandar Urdarevski" punuan ekipet e firmës ndërtimore „Bauer BG“. Në këtë projekt Qyteti i Shkupit do të investojë rreth 23,3 milion denarë, kurse afati i realizimit është 100 ditë.





RINOVHET PJESA E DYTË E RRUGËS "KOZLE" ...

Qyteti i Shkupit më 6-të qershor filloi fazën e dytë të rikonstruksionit të rrugës "Kozle" në komunën e Karposhit, në drejtimin nga kryqëzimi me rrugën "Jurij Gagarin" deri te kryqëzimi me rrugën "Nereshka".

Asfalti i vjetër dhe i dëmtuar në rrugën "Kozle" do të gërryhet, do të rinovohet shtresa e tamponuar dhe do të shtrohet me asfalt të ri. Rikonstruksioni i rrugës automobilistike do të shfrytëzohet për të vendosur kanalizim të ri atmosferik me gjatësi 275 metra, me vend derdhje të reja. Nga të dyja anët e rrugës automobilistike të rinovuar do të ndërtohen trotuare, me gjerësi të ndryshme 1,5 deri në 2,5 metra, në varësi të kushteve të terrenit. Trotualet do të shtrohen me pllaka begatoni, në sipërfaqe prej 2 000 metra katror. Në rinovimin e rrugës "Kozle" do të punojnë ekipet e kompanisë së ndërtimit „Pelagonija – Gostivar“, kurse afati i kryerjes së punëve është 90 ditë pune. Për

këtë punë ndërtimore Qyteti i Shkupit do të ndajë rreth 21,5 milion denarë.

Vitin e kaluar ekipet e Qytetit të Shkupit rinovuan 450 metra të rrugës "Kozle", në drejtimin nga stacioni i fundit

i autobusit me numër 57 deri te kryqëzimi me rrugën "Jurij Gagarin". Me përfundimin e fazës së dytë të rikonstruksionit, në rrugën "Kozle" do të rinovohen 1 300 metra.





... DHE PJESA E DYTË E RRUGËS "RADISHANSKA"

Deri në fund të kësaj vere ekipet e Qytetit të Shkupit do të rinovojnë rrugën në pjesën e dytë të rrugës automobilistike "Radishanska", nga hyrja e parë në lagjen Radishani deri para urës.

Vitin e kaluar Qyteti i Shkupit rinovoi rrugën "Radishanska" me gjatësi 750 metra, përgjatë tre hyrjeve në lagjen Radishani, në të cilën do të investojë 12 milion denarë. Me këtë punë ndërtimore, do të rinovohet pjesa e dytë e rrugës "Radishanska", në gjatësi 1 000 metra. Gjatë punëve ndërtimore në rrugën "Radishanska" do të riparohen gërmimet e kryera (nga rrjeti i kanalizimit dhe ujësjellësit të mëparshëm), do të vendosen bordura të reja dhe do të nivelohen pusetat dhe vend derdhjet ekzistuese. Asfalti i dëmtuar do të gërryhet dhe do të shtrohet shtresë e re asfalti, në sipërfaqe prej 8 000 metra katror. Në vende ku ka nevojë do të kryhet edhe riparimi i trotuareve të

dëmtuara.

Punët ndërtimore në këtë rrugë filluan pikërisht gjatë verës kur është zvogëluar intensiteti i qarkullimit rrugor në qytet. Në rinovimin e rrugës "Radishanska"

do të punojnë ekipet e kompanisë së ndërtimit „Eurodrvo“ nga Shkupi, kurse për rikonstrukcionin Qyteti i Shkupit do të shpenzojë rreth 9 milion denarë.



Rruga "Samoilova", që lidh komunat e Çairit dhe Qendrës, së shpejti do të rinovohet në gjatësi 2 020 metra. Me qëllim që të ruhet autenticiteti i ambientit nën Kalanë e Shkupit gurët kubik ekzistues do të rregullohen përsëri në gjatësi prej rreth 200 metra. Në pjesën e mbetur të rrugës "Samoilova" këto ditë po gërmohet asfalti i dëmtuar, rinovohet shtresa e tamponuar, kurse pastaj do të shtrohet shtresë e re asfalti me sipërfaqe 6 000 metra katror.

Përgjatë rrugës së rinovuar do të vendosen bordura të reja, dhe do të nivelohen edhe 45 puseta dhe 10 vend derdhje. Nga të dyja anët e rrugës do të ndërtohen trotuare të reja me gjerësi 1,5 deri në 2 metra, në varësi të kushteve të terrenit. Trotuaret do të shtrohen me pllaka begatoni.

Për rinovimin e rrugës "Samoilova" Qyteti i Shkupit do të ndajë rreth 31 milion denarë, kurse në terren punojnë ekipet e firmës ndërtimore „Bauer BG”. Afati i realizimit të punëve është 120 ditë.

PO RINOVHET EDHE RRUGA "SAMOILOVA"



Në rrugën "Samoilova" Qyteti i Shkupit dhe komuna Qendër paraprakisht ndërtuan rrjetin e ri të ujësjellësit,

kanalizimin fekal dhe atmosferik me vlerë rreth 30 milion denarë.





VAZHDON RINOVIMI I FASADAVE NË QENDËR

Ekipet e Qytetit të Shkupit këto ditë po punojnë në rikonstrukcionin e fasadës në ndërtesën në rrugën “Nikolla Vapcarov” numër 2, objektin mbi kafenenë „Trend”. Me projektin është parashikuar të rinovohet pjesa ballore e objektit e cila shikon nga sheshi i qytetit.

Punët rinovuese kryhen në sipërfaqe prej 210 metra katror, ku do të rregullohet pjesa sipërfaqësore e fasadës me material natyral dhe me izolim adekuat.

Projektin për rikonstrukcionin e kësaj fasade, pas konkursit të realizuar, e përgatiti „Zhagra kom” nga Shkupi, kurse punët ndërtimore i realizojnë punëtorët e firmës „Bauer BG”.

Rikonstrukcioni i kësaj fasade do të kushtojë rreth 3,5 milion denarë.



PO ZGJEROHET PARKINGU PËRBALLË PARKUT „AERODROM“

Parkingu përballë parkut „Aerodrom“ së shpejti do të zgjerohet dhe do të sigurojë hapësirë për parkimin e 250 automobila.

Kjo është faza e dytë e projektit për ndërtimin e vendeve të reja të parkimit në komunën e Aerodromit, në drejtimin nga bulevardi „Serbia“ deri te rruga „Fevruarski pohod“ me sipërfaqe 2.200 metra katror. Parkingu i ri do të jetë i gjatë 550 metra.

Për këtë projekt Qyteti i Shkupit ndau rreth 5,5 milion denarë, kurse në terren punojnë ekipet e NP „Rugë dhe rrugica“. Ky projekt është vazhdim

i përpjekjeve të Qytetit të Shkupit për përmirësimin e kushteve për parkim në

Shkup dhe për vendosjen e rregullit në parkim.



U MORËN 60 AUTOMJETE NGA TRANSPORTUES-TAKSI JOLEGAL

Qyteti i Shkupit vetëm për tre muaj nga zbatimi i masës së re për marrjen e përkohshme të automjeteve, të sjellë me ndryshimin e Ligjit për transportin në qarkullimin rrugor, mori përkohësisht gjithsej 60 automjete motorike nga transportuesit-taksi jolegal. Kundër të gjithë shkelësve, përveç masës së shqiptuar për marrjen e përkohshme të automjeteve, janë dorëzuar edhe kallëzime adekuate për

kundërvajtje. Gjopa për kryerjen jolegale të veprimtarisë auto-taksi është 500 euro në kundër vlerë në denarë.

Inspektorët e qytetit këtë masë e zbatojnë në bashkëpunim me MPB-në dhe me Agjencinë për menaxhimin me pronën e marrë.

Inspektorët për komunikacionin rrugor në periudhën e kaluar kryen rregullisht kontrollin e taksistëve të licencuar dhe kundër tyre janë dorëzuar

250 vendime për mënjanimin e mangësive që kanë të bëjnë me mosrespektimin e dispozitave për unifikim sipas Vendimit për transportin publik të udhëtarëve në territorin e Shkupit.

Për shkak të plotësimit të numrit të parashikuar, Qyteti i Shkupit deri më 16 nëntor të këtij viti nuk do të japë leje dhe certifikata të reja për licenca për transportues-taksi. Këshilli i Qytetit të Shkupit në seancën e 64-ët, të mbajtur më 03.05.2012, me ndryshimin e Vendimit për transportin auto-taksi në territorin e Qytetit të Shkupit, përcaktoi numrin e përgjithshëm prej 2 600 certifikatash të dhëna të licencave për automjete-taksi.

ARGËTIM PËR DITËLINDJEN E PARË TË TELEFERIKUT



Teleferiku që lidh Vodnon e Mesme me Kryqin e mileniumit më 2 qershor shënoi një vit nga ekzistimi i tij. Ndërmarrja e qarkullimit publik „Shkup“ e cila menaxhon me teleferikun në Vodnon e Mesme organizoi një argëtim të madh deri në orët e mëngjesit.

Vizitorët më të rinj u kënaqën me shfaqjen e fëmijëve të „Super xvezda“ dhe të zhonglerëve, kurse nga Agjencia për të rinj dhe sport u organizuan aktivitete sportive.

Për më të rriturit u organizua party-nate me elitën dixhej të skenës maqedonase.

Për një periudhë njëvjeçare pune me teleferik deri në Kryqin e mileniumit kanë hipur në Vodno mbi 500 000 qytetarë.



U ZGJIDH PROBLEMI ME UJËRAT E ZEZA NË SINGELIQ, EKONOMIJA DHE INXHIKOVË

Kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, kryetari i komunës Gazi Baba, Toni Trajanovski dhe ministri i ambientit jetësor dhe planifikimin e hapësirës, Abdilaqim Ademi më 11 maj zyrtarisht e lëshuan në përdorim kanalizimin e ujërave të zeza me stacion ripompimi për vendbanimet Singeliq - Ekonomija - Inxhikovë. Në vlerën e përgjithshme prej 35 milion denarë Qyteti i Shkupit investoi 15 milion denarë, Ministria e ambientit jetësor dhe planifikimit të hapësirës 10 milion denarë, kurse komuna gazi Baba - 10 milion denarë.

- Ndërtimi kësaj dege të kanalizimit primar të ujërave të zeza do të sigurojë përcjelljen e ujërave të zeza nga vendbanimi Ekonomija dhe nga pjesët e Singeliq, Stajkovci dhe Inxhikovë, nga rreth 1 000 amvisëri. Me këtë do të zgjidhen problemet shumëvjeçare të banorëve të këtyre vendbanimeve në këtë pjesë të qytetit – deklaroi kryetari Trajanovski.

Instalimi primar i kanalizimit të ujërave të zeza për Singeliq - Ekonomija - Inxhikovë ka gjatësi :

- Ø 600 – 1 622 metra,
- Ø 500 – 721 metra dhe
- Ø 800 – 250 metra.

Instalimi sekondar me profil 400 milimetra ka gjatësi 400 metra. Është ndërtuar edhe stacioni i ripompimit me kapacitet prej 300 l/sekondë. Në terren punuan ekipet e firmës së ndërtimit „Zhikol“,

„Tehnogradba“ dhe „Adonis“.

Me këtë projekt është realizuar edhe rrjeti (Ø 800) me gjatësi 250 metra, nga rruga automobilistike në Inxhikovë drejt stacionit të ripompimit në Maxhari, e cila në një të ardhme të afërt me ndërtimin e plotë të një pjese (Ø 800) do të mundësojë lidhjen e kanalizimit të ujërave të zeza në „Kadriovo mallo“ dhe „Tumba Maxhari“.





Në parkun e qytetit


MOS I SHËTISNI KANAKARËT NË SIPËRFAQET E NDALUARA

Qyteti i Shkupit për të mbrojtur sipërfaqet publike të gjelbra në Parkun qytetit, vendosi tabela me të cilat informohen qytetarët ku mund të lëvizin dhe si duhet të sillen me kanakarët e tyre kur shëtisin nëpër park, dhe në të njëjtën kohë t'i respektojnë dispozitat ligjore.

Qyteti i Shkupit në pjesën e dytë të

Parkut të qytetit, ndërtoi park të veçantë për kanakarët, vendosi tabela dhe shënoi sipërfaqet ku kanakarët mund të shëtisin lirisht. Me këtë, Qyteti i Shkupit iu përgjigj kërkesave të qytetarëve të cilët ruajnë kanakarë, por edhe kërkesave të qytetarëve të cilët shëtisin me fëmijët e tyre në Parkun e qytetit.

Nëse dikush nga pronarët e kanakarëve nuk e respekton Udhëzimin e vendosur dhe shëtit kanakarin në sipërfaqet e gjelbra në Park ku nuk është e lejuar, do të intervenojnë ruajtësit e rendit komunal dhe do të gjobisin pronarët.



Vend për kanakarët në Parkun e qytetit

Liçeni i matkës në muajin maj u pasurua me 10 000 copë peshq troftë maqedonase - *Salmo macedonicus* (Karaman,1924). Pasurimi me peshq i liçenit të Matkës, u kryhet për të pestin vit me radhë.

Projekti për mbrojtjen, rigjallërimin dhe futjen e sërishme të troftës maqedonase - *Salmo macedonicus* (Karaman,1924) në ujërat e Republikës së Maqedonisë ka si qëllim të mundësojë mbrojtjen e troftës maqedonase dhe të rrisë numrin e peshqve në rrjedhën e lumit Treska, duke përfshirë akumulimin Matka dhe rrjedhën e sipërme të lumit Vardar. Me këtë projekt do të mbrohet trofta maqedonase si pjesë e trashëgimisë së pasur natyrore të kanionit të Matkës, do të pasurohet oferta turistike nëpërmjet zhvillimit dhe promovimit të peshkimit rekreativ dhe sportiv me kualitet të lartë, do të ngrihet vetëdija tek publiku për llojet endemike të peshqve, do të rritet roli i turizmit dhe do të angazhohet bashkësia në vendet atraktive turistike me qëllim që të vendoset turizëm i mundshëm ekonomik, i qëndrueshëm dhe ekologjik.

Për herë të pestë U PASURUA ME PESHQ LIÇENI I MATKËS



Financues kryesor të pasurimit me peshq, përveç Qytetit të Shkupit janë edhe Instituti për blegtori – Seksioni për peshkim,

Federata maqedonase e peshkimit dhe Shoqata e peshkatarëve sportivë – „Vardar“.



Për majmunët në Kopshtin zoologjik muajin e kaluar u ndërtua një vendbanim i ri. Shtëpia e tyre e re ka pjesë të brendshme dhe të jashtme, kurse në të do të rregullohen dymbëdhjetë majmunë, gjashtë anëtarë të familjes patasi dhe pesëmbëdhjetë lemurë me të vegjlit.

Pjesa e brendshme e vendbanimit është e ndarë në dy pjesë me sipërfaqe nga 100 metra katror, kurse pjesët e jashtme janë me sipërfaqe të përgjithshme 300 metra katror, ku janë rregulluar elementë të ndryshëm për zbatimin e majmunëve të përgatitura nga plastika dhe druri.

Vendbanimi për majmunët është donacion i Qytetit të Shkupit, kurse



VENDBANIM I RI PËR MAJMONËT NË KOPSHTIN ZOOLOGJIK

ndërtimin e tij e financoi Agjencia për Maqedonisë. Ndërtimi i vendbanimit për komunikime elektronike e Republikës së majmunë kushtoi rreth 5 milion denarë.



ME TREN TURISTIK NËPËR KOPSHTIN ZOOLOGJIK

Kopshti zoologjik u bë me tren turistik, donacion nga Telekom i Maqedonisë SHA dhe T – Mobile Maqedonia. Treni është i gjatë dhjetë metra, ka 2 vagonë dhe është me kapacitet prej 36 ndenjësesh. Ka dizajn modern dhe është i vetmi i këtij tipi në regjion.

Treni i ri është i destinuar për shëtitje edukative nëpër kopshtin zoologjik, ka zërim të mirë, kurse për shëtitjet turistike do të angazhohet edhe ciceron.





SHKUPI I LULËZUAR

Qyteti i Shkupit, nga muaji i kaluar punon në mënyrë aktive në mbjelljen e luleve në shumë lokacione në qytet.

Në projektin "Shkupi i luëzuar", i cili ka për qëllim të zbukurojë qytetin deri tani janë mbjellur mbi gjysmë milion lule, kurse deri në fund të vitit do të mbillen 1.500.000 lule.

Në pjesën e parë të Parkut të qytetit janë formuar gjashtë ngastra të reja me lule, nga të cilat dy janë në formën e kërmillit, ku janë mbjellë pesë petuin,

impate dhe begonin, kurse me begon dhe salvija janë mbjellë ngastrat në gjelbërimin e stacionit të autobusëve para shatërvanit „Lulja e zambakut“. Gjithashtu, 900 petuin janë mbjellë në ngastrën nën qershitë japoneze në Park. Para hyrjes në kopshtin zoologjik, në gjelbërim janë formuar ngastra në të cilat janë mbjellë impate, nën çdo tuja janë formuar rrathë në të cilët janë mbjellë njëra pas tjetrës begon dhe tagetis, kurse në të dyja ngastrat në formë rrethi, përballë barakave të Qytetit

të Shkupit, janë mbjellë 2 000 copë begon dhe impate.

Në gjelbërimin në bulevardin „Ilinden“, para godinës së Gjendjes civile, janë formuar ngastra në të cilat janë mbjellë salve, petuin dhe tagetis, kurse para ndërtesës së Gjeneral shtabit të ARM



janë formuar ngastra në formë trekëndëshi në të cilat janë mbjellë impate me bordurë koliusi.

Ekipet e Qytetit të Shkupit rregulluan edhe tre zhardinierë në bregun e lumit Vardar, prapa godinës së Qeverisë, ku janë mbjellë tagetis. Zbukurimi me lule sezonale si salvoja, tagetis dhe celozija u krye edhe në zhardinierën para godinës së Qeverisë, si dhe në 5 trekëndëshit me nga 60 metra katror në kryqëzim.

Në sipërfaqet e gjelbra të Kalasë janë formuar 3 rundelë me nga 25 metra katror me shumë lloje lulesh. Në bulevardin "Sveti Kliment Ohridski" janë formuar disa

lenta me sipërfaqe të ndryshme në të cilat janë mbjellë rreth 5 000 lule.

Para bibliotekës universitare „Shën. Klimenti“ janë formuar 5 ngastra, nga të cilat 2 janë në formë luleje, me sipërfaqe prej 15 deri në 25 metra katror.

Në parkun e lagjes Gjorçe Petrov në dy ngastra katrore janë mbjellë rreth 1 000 lule. Në bulevardin "Aleksandar Makedonski", në hyrjen e Shkupit tek kryqëzimi „Agroservis“, nga ana e djathtë me lule është bërë flamuri i Republikës së Maqedonisë, kurse nga ana e majtë është stema e Shkupit. Në zhardinierën e mesme janë formuar tre ngastra, të gjata 6 metra

dhe të gjera 2 metra, në të cilat janë mbjellë petuin, impate dhe tagetis janë formuar edhe bordura prej koliusi.

Në drejtim të fabrikës „Alkaloid“ deri te kryqëzimi tek hoteli Kontinental, nga ana e majtë dhe e djathtë, janë formuar 24 ngastra me impate, begon dhe xhunxhula. Në zhardinierën tek kryqëzimi janë formuar dy trekëndësha me nga 55 metra katror në të cilat në një metër katror janë mbjellë 25 lule petuin, impate, begon dhe tagets. Gjithashtu, mbi kryqëzim është formuar ngastër me sipërfaqe 67 metra katror në formë trekëndëshi në të cilën janë mbjellë tagets, impate dhe begon.



Në periudhën nga 15 prilli deri më 15 maj kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, vizitoi komunat e Shkupit, u takua me kolegët e tij kryetarë të komunave dhe me përfaqësues të administratës së komunave dhe me bashkëqytetarët e tij dhe bisedoi për problemet me të cilat ballafaqohen çdo ditë qytetarët në Shkup.

Gjatë vizitës së komunën e Butelit kryetari Trajanovski si projekte më të rëndësishme të cilat do të realizohen këtë vit theksoi vazhdimin e rikonstruksionit të rrugës "Radishanska" ndërtimin e unazës ndërmjet rrugëve "Aleksandar Udarevski" dhe "Boca Ivanova" si dhe pastrimin e marrëdhënieve të pronësisë juridike për zgjerimin e bulevardit "Hristijan Todorovski Karposh" deri në unazën e madhe. Në komunën e Çairit për këtë vit është planifikuar ndërtimi i unazës ndërmjet rrugëve "Llazo Trpovski" dhe "Vtora makedonska brigada" dhe ndriçimi i ri për Çarshinë e vjetër të Shkupit.

Në takimin me kryetarin e komunës së Sarajit, Bekim Murati, u bisedua për shumë tema dhe projekte, ndërmjet të cilave edhe për ndërtimin e urës në lumin e Vardarit. Në takimin në komunën e Kaposhit me kryetarin e saj Stevço Jakimovski, për vitin 2012 kryetari Trajanovski bëri të ditur një seri projektesh të mëdha infrastrukturore, siç janë zgjatimi dhe zgjerimi i bulevardit "Mitropolit Tedosij Gologanov", zgjerimi i bulevardit "Ilinden", rikonstruksioni i rrugës Kozle (faza e dytë) dhe ndërtimi i bulevardit "Manapo" në bashkëpunim me komunën e

CIKLI I SHTATË I VIZITAVE NË KOMUNAT E SHKUPIT



Karposhit.

Ndërtimi i unazës tek kisha „Shën. Petar dhe Pavle“ është projekti më i madh që do të realizohet në vitin 2012 në territorin e komunës Gjorçe Petrov. Si projekt më i madh për këtë vit që u bë i ditur gjatë vizitës në komunën e Aerodromit është rikonstruksioni i një pjese të bulevardit "Jane Sandanski" dhe ndërtimi i vendeve të reja të parkimit në shumë lokacione, përdërisa në komunën e Shuto Orizares do të vijojë faza e dytë e rikonstruksionit të rrugës "Pelagonija".

Në komunën Qendër, kryetari Trajanovski theksoi ndërtimin e fazës së dytë të bulevardit "Sveti Kliment Ohridski", rikonstruksionin e rrugës Samoilova, si dhe

vazhdimin e ndërtimit të garazheve me kate në territorin e qendrës së qytetit. Projekti më i madh që do të realizohet në territorin e komunës së Kisela Vodës është ndërtimi i bulevardit "Prvomajska".

Cikli i ardhshëm i vizitave është parashikuar për muajin nëntor, ku theksi më i madh në takime do të vendoset në propozimet e komunave dhe bashkësive vendore për projekte të cilat duhet të hyjnë në buxhetin e Qytetit të Shkupit për vitin e ardhshëm.

ADRESË E RE E QYTETIT TË SHKUPIT

Qyteti i Shkupit duke vepruar në përputhje me plotësimin e Ligjit për emërtimin e rrugëve, shesheve dhe objekteve të tjera infrastrukturore, pas procedurës së realizuar mori adresën Bulevardi Ilinden numër 82, 1000 Shkup. Adresa e ndryshuar është futur edhe në regjistrin adekuat të Regjistrat qendror të Republikës së Maqedonisë dhe me këtë, kjo adresë u bë adresa zyrtare e Qytetit të Shkupit. Në përputhje me ndryshimin e kryer, Qyteti i Shkupit njofton të gjithë personat fizikë dhe juridikë, se kjo adresë tashmë është në përdorim zyrtar.



U NËNSHKRUA MARRËVESHJA PËR BASHKËPUNIM ME QYTETIN E TORINOS

Më 23 maj në Torino kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski dhe kryebashkiaku i Torinos, Piero Fasino, nënshkruan marrëveshje për miqësi dhe bashkëpunim ndërmjet dy qyteteve. Në suazat e këtij bashkëpunimi Qyteti i Shkupit do të fillojë aktivitet për formimin e zyrës për planifikimin hapësinor dhe urbanistik (Qendra urbane - Shkup), misioni i së cilës do të jetë që nëpërmjet analizës së aspektit urbanistik, arkitektonik, ekonomik dhe kulturor në procesin e zhvillimit të qytetit të sigurohen informacione objektive, analitike dhe relevante me interes për qytetin e Shkupit.

- Projekti Qendra urbane - Shkup përbën vetëm fillimin e bashkëpunimit ndërmjet qyteteve të Shkupit dhe Torinos dhe do të realizohet në suazat e



bashkëpunimit shumëvjeçar të suksesshëm dhe të frytshëm të Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Italisë. Në këtë aspekt presim bashkëpunimin dhe përkrahjen e Qendrës urbane metropolitane të Torinos – deklaroi në fjalën e tij kryetari Koce Trajanovski.

Para nënshkrimit të marrëveshjes për bashkëpunim të Shkupit dhe Torinos, kryetari Trajanovski mori pjesë në Forumin e biznesit në Torino në të cilin u prezantuan mundësitë që ofron Republika e Maqedonisë për investitorët potencial.

MEMORANDUM PËR QYTETET EFIKASE ENERGJETIKE

Sekretarja e Qytetit të Shkupit, Gordana Klinçarova, në Sarajevë, së bashku me kryebashkiakët e Sarajevës, Podgoricës, Tiranës, Zagrebit dhe Frajburgut nënshkruan Memorandumin për mirëkuptim ndërmjet qyteteve të Europës Juglindore. Akti i nënshkrimit të Memorandumit për mirëkuptim është fillimi zyrtar i projektit „Fuqizimi i rrejtës të qyteteve energjetike efikase në Europën Juglindore“ që do ta realizojnë administratat e qyteteve nënshkrues dhe partneri dhe iniciuesi i projektit SIGJ-Shoqata gjermane për bashkëpunim ndërkombëtar.

Qëllimi i këtij memorandumi është që të përcaktohet struktura e Rrejtës të ardhshme për efikasitet energjetik (EE) ndërmjet qyteteve të Europës Juglindore

për arritjen e marrëveshjes së përbashkët për bashkëpunimin e ardhshëm në projekt. Qëllimi i formimit të Rrejtës është që të këmbëhen dijet dhe eksperiencat e lidhura me realizimin e masave për rritjen e efikasitetit energjetik dhe zvogëlimin e emisionit të CO2. Këto masa janë përcaktuar në Planet aksionare për zhvillim të qëndrueshëm energjetik të qyteteve, si dhe në strategjitë e tjera dhe planet e tjera aksionare të sjella në shkallë qytetesh, dhe të

lidhura me EE dhe shfrytëzimin e burimeve të ripërtërshme të energjisë etj. Qëllimi i projektit është ndihma dhe përkrahja rreth organizimit të Rrejtës, si dhe ndihma për implementimin e masave të lidhura me Planet aksionare për zhvillim energjetik të qëndrueshëm të qyteteve.



Kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski më 10 qershor edhe zyrtarisht hapi Qendrën ditore për persona të moshuar dhe Qendrën për dhënien e ndihmës në kushte shtëpiake, të cilët gjenden në ambientet e shtëpisë „Dare Xhambaz“, në rrugën „11.Oktomvri“ dhe në rrugën „Vukarovska“ numër 23, në komunën e Çairit.

- Qyteti i Shkupit për realizimin e këtij projekti nga Buxheti ndau 2 milion denarë. Në këto qendra çdo ditë realizohen edukime në tema që janë interesante dhe të dobishme për personat e moshuar, lojëra shoqërore ose me karakter garues si bingo, shah, pikado, do të organizohen punëtori të ndryshme kreative, si dhe shëtitje të përbashkëta. Në këtë mënyrë do të mundësohet mënyrë e organizuar e kalimit të kohës të personave të moshuar, por edhe socializim i tyre i ndërsjellët. Gjithashtu, 60 persona të sëmurë të cilët jetojnë vetëm do të kenë përkujdesje, pikërisht shërbime mjekësore dhe sociale në kushte shtëpiake: matja e sheqerit në gjak, matja e tensionit të gjakut, dhënia e këshillave për ushqim, ndihmë në blerjen e produkteve ushqimore, ilaçeve etj, shoqërimi i personave të moshuar gjatë shkuarjes tek mjeku, në shëtitje, si dhe aktivitete të tjera për socializim. Në këtë qendër është hapur

U HAP QENDRA DITORE PËR PERSONA TË MOSHUAR



linjë telefonike me të cilën qytetarët do të kenë mundësi të telefonojnë dhe të marrin informacione për funksionimin e Qendrës ditore dhe mundësitë për shfrytëzimin e shërbimeve – theksoi kryetari Trajanovski, në hapjen e qendrës.

Ministria për punë dhe politikë sociale me pajisjet e nevojshme dhe inventar mori pjesë në adaptimin dhe pajisjen e Qendrës ditore, kurse për këtë aktivitet ministria ndau 700 000 denarë.

Qyteti i Shkupit do të kujdeset për

zhvillimin e programit në Qendrën ditore dhe për atë që personat e moshuar të marrin trajtim adekuat dhe përmbajtje me kualitet që do të pasurojnë jetën e tyre të përditshme, kurse të punësuarit në Kryqin e kuq të qytetit të Shkupit - 1 punëtor social, 1 psikolog, 4 infermierë dhe 34 vullnetarë do të kujdesen për kualitetin e programit, të destinuar për personat e moshuar, që do të vizitojnë qendrën ditore. Vizita në shtëpi për fillim do të kryhet për rreth 180 persona të moshuar.



U NËNSHKRUA KONTRATA NDËRMJET QYTETIT TË SHKUPIT DHE LIDHJES SË PENSIONISTËVE

Qyteti i Shkupit dhe Lidhja e shoqatave të pensionistëve të qytetit të Shkupit (LSHP) lidhën kontratë me të cilën Qyteti i Shkupit obligohet të marrë pjesë financiarisht në rinovimin e Qendrës rekreative „Katlanovë“. Në emër të Qytetit të Shkupit kontrata u nënshkrua nga kryetari Koce Trajanovski, kurse në emër të LSHP-së nga kryetari i Lidhjes, Krste Angelovski.

Qyteti i Shkupit do të marrë pjesë me 500 000 denarë në rinovimin e Qendrës rekreative „Katlanovë“ për të aftësuar për përdorim ambientet për rekreacionin e pensionistëve. Në vitin 2011 për rinovimin e pushimores në QR „Katlanovë“ Qyteti i Shkupit ndau 350 000 denarë.

U NDANË DIPLOMAT PËR 25 ZJARRFIKËS

Në SHMQSH „Marija Kyri-Sklodovska“ më 9 maj u ndanë diplomat e kandidatëve të parë të cilët vitin e kaluar ndoqën dhe përfunduan trajnimin modular për profesionin e zjarrfikësit. Diplomati 25-së kandidatëve ua ndau kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski.

- Këtë trajnim e filluam para disa muajsh dhe me të vërtetë jam i kënaqur që këtë vit e përfunduam me sukses. Këtë projekt e filluam për shkak të nevojës së Brigadës për mbrojtjen kundër zjarrit. Pas vitit 1994 kjo është hera e parë që kemi zjarrfikës të arsimuar, që është shumë e rëndësishme për Qytetin e Shkupit. Pas përfundimit të trajnimit kandidatët fituan të drejtën për certifikatë për zjarrfikës dhe besoj se të gjithë 25 kandidatët janë të përgatitur plotësisht t'u përgjigjen detyrave. Si rezultat i bashkëpunimit ndërkombëtar me brigadat për mbrojtjen kundër zjarreve të vendeve të tjera, shpresoj se do të vazhdoni të trajnoheni në mënyrë

plotësuese jashtë vendit dhe do të jeni përfaqësues të denjë të vendit tonë në garat me karakter ndërkombëtar – tha kryetari Trajanovski.

Trajnimi modular filloi vjet më 26.10.2011, në SHMQSH „Marija Kyri-Sklodovska“. Trajnimi përbëhet nga pjesa e teorisë së përgjithshme dhe pjesa teorike profesionale me trajnim praktik me mbi 800 orë mësimore, nga të cilat 530 orë janë

mësim teorik dhe 270 trajnim praktik. Në bazë të rezultateve të arritura në provimin përfundimtar, kandidatët morën certifikatë dhe vërtetim për aftësi profesionale në profesionin e zjarrfikësit, gjë me të cilën vërtetohen kompetencat e fituara. Kandidati me sukses më të mirë ishte Mihail Karakolev me sukses mesatar 5,00.

Ky projekt u financua plotësisht nga Qyteti i Shkupit.



U KREMTUA DITA E ZJARRFIKËSVE

Dita e zjarrfikësve – 20 maji u kremtua në stacionin për mbrojtjen kundër zjarrit Autokomanda me roje nderi solemne të Brigadës për mbrojtjen kundër zjarrit dhe me ushtrime-treguese taktike.

- Vitin e kaluar u tejkaluan të gjitha të dhënat statistikore në lidhje me numrin e zjarreve, gjithsej 1 513 në territorin e Shkupit dhe gjatë kësaj u realizuan në mënyrë të suksesshme të gjitha intervenimet. U realizuan me sukses edhe 182 intervenime teknike (aksidente automobilistike, aksidente teknologjike, nxjerrje e të mbyturve etj). Me një investim prej 1 200 000 denarësh u ble dhe u zëvendësua antena e vjetër e amortizuar për funksionimin normal të radio lidhjeve të cilat janë të domosdoshme në punën e përditshme të njësisë. Pas një kohe të gjatë u bë edhe riparimi i platformës hidraulike e cila tani është në gjendje të rregullt gjë me



të cilën janë krijuar kushte për intervenim të suksesshëm të Brigadës për mbrojtjen kundër zjarreve të Qytetit të Shkupit në rastet kur ka nevojë për intervenime në

lartësi – tha kryetari Koce Trajanovski, në kremtimin e ditës së zjarrfikësve.

SHPËRBLIME PËR MATEMATIKANËT MË TË MIRË

Kryetari Koce Trajanovski më 5 qershor u ndau diplomat dhe vendimet për shpërblime në të holla fituesve të garës së parë në matematikë ndërmjet nxënësve të shkollave të mesme të Qytetit të Shkupit, e cila u mbajt më 05.05.2012 në SHMQSH „Georgi Dimitrov“. Gjimnazistët e vitit të parë, të dytë dhe të tretë matën njohuritë e tyre në lëndën e matematikës dhe u ndanë në dy grupe, sipas programeve mësimore, përkatësisht nxënës të arsimit gjimnazial dhe atij profesional.

Në garën ndërmjet nxënësve të vitit të parë – arsim gjimnazial vendin e parë e fitoi Tamara Simjanovska nga SHMQSH



„Rade J. Korçagin“. Ndërmjet garuesve të vitit të dytë – arsim gjimnazial më e mira ishte Eva Pançevska nga SHMQSH „Georgi Dimitrov“, kurse nga pjesëmarrësit e vitit të tretë – arsim gjimnazial, vendin e parë e fitoi Damjan Angelkovski nga SHMQSH „Rade J. Korçagin“.

Në garën ndërmjet nxënësve të vitit të parë – arsim profesional vendin e parë e fitoi Daniel Cvetanovski nga SHMQSH „Marija K. Sklodovska“. Ndërmjet garuesve të vitit të dytë – arsim profesional më i miri ishte Jovica Todorov nga SHMQSH „Pançe Karagjozov“, kurse nga pjesëmarrësit e vitit të tretë – arsim profesional e para ishte Ivana PetrovSka, nga SHMQSH „Vlado Tasevski“. Garuesit për vendin e parë të fituar morën diplomë dhe shpërblim në të holla me vlerë 4 000 denarë, për vendin e dytë 3 000 denarë, dhe për vendin e tretë 2000 denarë.

GJIMNAZISTËT FOLËN HAPUR KUNDËR DHUNËS

„Fol hapur për dhunën“ ishte motoja e manifestimit përfundimtar të projektit „Zvogëlimi i dhunës dhe rritja e sigurisë në shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit“ i cili u mbajt më 6 qershor në oborrin e shkollës së mesme „Pançe Arsovski“. Projekti për zvogëlimin e dhunës, i cili u realizua për muaj me radhë në të gjitha shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit, ka për qëllim t'i trajnojë shkollat të zhvillojnë politika shkollore, protokolle dhe programe për preventivë, identifikimin dhe ballafaqimin me dhunën. Në këto aktivitete u përfshinë mbi njëqind mësues

dhe bashkëpunëtorë të tjerë profesional, të organizuar në ekipe, të cilat punuan në zhvillimin e procedurave shkollore dhe aktiviteteve për zvogëlimin e dhunës. Projekti është iniciuar nga Qyteti i Shkupit.

- Qyteti i Shkupit në vazhdimësi dhe me përkushtim punon për rritjen e sigurisë në shkollat dhe përkrah të gjitha aktivitetet për pengimin dhe ballafaqimin me dhunën në shkollat. Prandaj përshëndes idenë që nëpërmjet muzikës të dërgohet mesazh dhe hapur të flitet për ndërprerjen e dhunës, si dhe të bëjmë thirrje së bashku



për të ndërtuar një botë bashkëjetese, në paqe dhe me tolerancë – theksoi kryetari Koce Trajanovski.

Në manifestimin të cilin e organizoi ekipi për zvogëlimin e dhunës i SHMQSH „Pançe Arsovski“, morën pjesë grupe muzikore dhe interpretues individual nga 12 shkolla të mesme, të cilët me pjesëmarrjen e tyre dhanë kontribut në promovimin e jetës shkollore pa dhunë dhe bashkëjetesës.



U LUAJT KUADRIL NË SHESHIN „MAQEDONIA“

Në sheshin „Maqedonia“ më 18 maj u mbajt „Parada e maturës 2012“ e gjashtë, kurse maturantëve nga Shkupi i bashkëngjitën edhe moshatarët e tyre nga gjashtëdhjetë qytete nga vendi dhe nga Europa të cilët në të njëjtën kohë, në mesditë, luajtën vallëzimin „Kuadril“ në tingujt e operës së Shtrausit „Lakuriqi i natës“.

Në „Parada e maturës“ të sivjetme në Shkup morën pjesë 988 nxënës nga



tetëmbëdhjetë shkolla të Qytetit të Shkupit, që përbën numrin më të madh në gjashtë vitet e kaluara. Parada e maturës u mbajt në Strumicë, Ohër, Resnje, Strugë dhe në Gjevgjeli. Para fillimit të vallëzimit „Kuadril“, maturantët bënë betimin për tolerancë dhe

jo për dhunën.

Qyteti i Shkupit është sponsori kryesor i këtij manifestimi tradicional, kurse organizatorë janë Drejtoria për kulturë dhe art e Qytetit të Shkupit dhe klubi i vallëzimit „Ritam plus“.

TAKIMI NDËRMJET TË PARIT DHE MË TË MIRËVE



Kryetari Koce Trajanovski, në suazat e manifestimit tradicional „Takimi ndërmjet të parit dhe më të mirëve“, maturantëve më të mirë – nxënësve më të mirë të gjeneratës 2008/2012 nga 21 shkollat e mesme të u ndau mirënjohje dhe shpërblime në të holla.

- Të nderuar nxënës më të mirë të gjeneratës, duke organizuar këtë manifestim, Qyteti u jep mirënjohje për rezultatet e arritura, kurse Ju me sukseset dhe arritjet tuaja tregoni se mund të keni sukses, të luftoni si shokë bashkë me moshatarët tuaj dhe të arrini rezultate në

nivel të Qytetit të Shkupit dhe Republikës së Maqedonisë, me pritje që ato t’Ju çojnë në gara edhe në nivel ndërkombëtar. Praktika tregon se çdo njeri i ri, i cili ka qenë nxënësi më i mirë i gjeneratës së vet, ndërton të ardhme të suksesshme dhe arrin rezultate cilësore në rrugën e zhvillimit të mëtejshëm. Kjo është rruga deri te dhurata më e madhe dhe mirënjohja që çdo njeri e posedon - dijet. Kurse ne edhe më tej do të vazhdojmë t’i motivojmë gjeneratat e ardhshme drejt qëllimeve dhe arritjeve më të larta shkollore - theksoi kryetari Trajanovski.

Qyteti i Shkupit organizoi edhe ekskursion njëditor „Në gjurmët e krijuesve të qytetit“, si shpërblim për suksesin e arritur, në të cilin morën pjesë mbi 50 gjimnazistë nga të cilët një pjesë ishin nxënësit më të mirë të gjeneratës, kurse pjesa tjetër ishin maturantë që kanë treguar sukses gjatë shkollimit.

Nxënësit më të suksesshëm nga të gjitha shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit vizituan monumentet nga trashëgimia historike dhe kulturore dhe u njohën me historinë e pasur, kulturën dhe traditën e jetës multikulturore në Shkup.

„FINAL FOUR“ I SHKOLLAVE TË MESME TË QYTETIT



Në sallën sportive „Rasadnik“ në Kisela Voda më 27 prill u mbajt garat finale të shkollave të mesme të qytetit „Final four“ për vitin shkollor 2011/2012 në volejboll, hendboll, basketboll dhe futsall.

Në garën finale në volejboll për meshkuj fituan nxënësit e SHSHKF „M.M.Brico“, kurse në konkurrencën për femra më të mira ishin volejbollistet e SHMQSH „Georgi Dimitrov“.

Në finalen në futsall, në konkurrencën për femra ishin gjimnazistet e SHSHKF „M.M.Brico“. Moshatarët e tyre nga SHSHKF „M.M. Brico“ fituan ndeshjen në futsall në konkurrencën për meshkuj.

Në basketboll fituan nxënësit e SHMQSH „Orce Nikollov“. Në konkurrencën për meshkuj në ndeshjen finale fituan basketbollistet e „Vasil Antevski-Dren“.

Në ndeshjet finale në hendboll në konkurrencën për femra, si më të mira u paraqitën vajzat e SHSHKF „M.M. Brico“, kurse në konkurrencën për meshkuj më të suksesshëm ishin hendbollistet e SHSHKF „M.M. Brico“.

U HAP TERRENI SPORTIV PËR VOLEJBOLL NË PLAZHIN „PARK“

Terreni sportiv për volejboll në rërë në Plazhin e qytetit „Park“ filloi të punojë. Terreni sportiv është i hapur çdo ditë nga ora 10 deri në orën 24.

Caktimi i orarit për luajtje mund të kryhet nëpërmjet telefonave: 3297 – 238 dhe 3297 – 320 çdo ditë pune deri në orën 16:30, ose direkt në terrenin sportiv për volejboll. Të gjithë nxënësit e interesuar, qytetarë, klube sportive dhe shoqata civile, mund të shfrytëzojnë falas terrenin për volejboll në rërë në Plazhin e qytetit „Park“. Orari për shfrytëzimin falas është me kohëzgjatje prej 1 ore.

Së shpejti do të fillojë të punojë edhe terreni për volejboll pranë Plazhit të qytetit „Ura e gurit“.





KENIANËT MË TË MIRËT NË MARATONËN E SHKUPIT 2012

Kenianët Patrik Miçemi Vambugu dhe Sesilis Vangui Varutumu triumfuan në MARATONËN E SHKUPIT 2012 që u mbajt në rrugët e Shkupit më 6 maj. Në këtë edicion të manifestimit tradicional sportiv morën pjesë 3 500 vrapues.

Në maratonë, nga vrapuesit vendas-maqedonas më të mirë ishin Trpe Martinovski dhe Vesna Kiraxhieva. Në garën e gjysmë maratonës vendi i parë i takoi Sasha Stoliq nga Serbia, kurse tek femrat më e shpejta ishte Agnes Kish nga Hungaria. Në suazat e garës humanitare në 5 km, gjashtë vendet e para për meshkuj dhe femra janë Millosh Danciq, Aleksandar Stojanovski dhe Kire Stojanovski, Rosica Kostova, Edisa Shabanoviq dhe Marija Atanasovska. Kjo garë ka karakter rekreativ dhe humanitar. Në këtë garë morën pjesë në mënyrë të organizuar rreth 1 000 nxënës të shkollave të mesme në Shkup, kurse mjetet nga kuotizacioni i paguar janë destinuar për qëllime humanitare, për Kryqin e kuq të qytetit të Shkupit për pajisjen e qendrës për të pastrehët.

Këtë vit u mbajt edhe gara në 1 km, mini-maratona Çunga Lunga e Shkupit,

gara për fëmijë për shkollat fillore. Në këtë garë morën pjesë rreth 600 nxënës të shkollave fillore nga Shkupi. Gara kishte karakter garues dhe më i mirë ishte Stefan

Novevski.

Sponsorë të këtij manifestimi tradicional janë Qyteti i Shkupit, Agjencia për të rinj dhe sport dhe Misioni i BE-së Shkup; organizatorë teknik janë Lidhja e sporteve të Maqedonisë dhe KA „Rabotnički“, kurse ko-organizatorë është Federata e atletikës e Maqedonisë. Përveç përkrahjes financiare, Qyteti i Shkupit nëpërmjet ndërmarrjeve të tij publike ofroi edhe ndihmë logjistike, kurse ndihmues të Maratonës së Shkupit janë edhe Ministria e punëve të brendshme, Kryqi i kuq i Qytetit të Shkupit, Fakulteti për kulturë fizike dhe ARM.

Maratona e Shkupit është anëtare e AIMS (Asociacioni i maratonave dhe garave të rrugës) me certifikatë të licencuar për korsi. Maratona e Shkupit ka hyrë në kalendarin e Asociacionit evropian të atletikës (EAA) dhe Asociacionit botëror të federatave të atletikës (IAAF). Me rëndësi të veçantë është pranimi i sërishëm i Maratonës së Shkupit në listën e maratonave të shpallura nga IAAAF në të cilat mund të plotësohen normat për Lojërat olimpike verore Londër 2012.





BASKERFEST 2012

Vizitorët në festivalin e rrugës „Baskerfest 2012“, i cili u mbajt nga data 1 deri më 10 qershor, kishin mundësi të zbavitën me pikat fantastike të tridhjetë, vallëzuesve, zhonglerëve, akrobatëve dhe muzikantëve nga Australia, Kanadaja, Argjentina, Polonia, Italia, Zelanda e Re, SHBA, Gjermania, Irlanda, Japonia dhe nga Bolivia.

Ky eveniment ndërkombëtar, multikulturor, i rrugës me të cilin pasurohen përmbajtja kulturore dhe zbavitëse e Shkupit është nën organizimin e „One Way“, dhe nën kujdestarinë e Qytetit të Shkupit. Festivali i rrugës „Baskerfest“ këtë vit u mbajt për të shtatën herë.

„DITË TË ARTIZANATIT 2012“

Në Çarshinë e vjetër të Shkupit, në ambientet e Dhomës ekonomike të Shkupit, më 29 maj filloi manifestimi tradicional „Ditë të artizanatit 2012“. Si pjesë e manifestimit, në Çarshi u mbajt Panairi i pranverës me punime dore vendase në të cilin u prezantuan të gjitha zanatet, nga më të vjetrat deri te ato më modernet.

Shkollat e mesme profesionale të Shkupit prezantuan profesionet që i mësojnë nxënësit dhe theksuan dijen e këtyre kuadrove për artizanatin dhe ekonominë, me qëllim që të rritet imazhi i arsimit të mesëm profesional, të nxiten

të rinjtë të regjistrohen në shkollat e mesme profesionale dhe të mësojnë profesionet artizanale të cilat ofrojnë perspektivë dhe punësim.

Qyteti i Shkupit vazhdon bashkëpunimin me Dhomën ekonomike të Shkupit, e cila këtë vit shënon 80-të vjet nga ekzistimi i saj, duke marrë pjesë në projektin „Qyteti i zanateve të lashta“, formimi i qendrave për trajnim, organizimi



i manifestimit „Panairi i pranverës i punimeve të dorës“, si dhe bursa për nxënësit më të mirë në shkollat e artizanatit të Qytetit të Shkupit.

FILLOI „VERA E SHKUPIT 2012“

Me koncertin e Filarmonisë së Sofjes, nën dirigjimin e Borjan Canev dhe me interpretimin solistik të Ana Kondratenko më 21 qershor në Operën dhe baletin maqedonas filloi edicioni i 33-të i manifestimit kulturor ndërkombëtar „Vera e Shkupit 2012“. Ky manifestim tradicional fillon ditën e parë të verës, por edhe në Ditën botërore të muzikës.

- Edhe këtë vit, adhuruesit e artit do të kenë mundësi të ndjekin një numër të madh shfaqjesh kulturore – artistike dhe zbavitëse në të cilat do të prezantohen artistë dhe ansamble nga vendi dhe jashtë vendit, duke prezantuar arritjet e tyre dhe inspirimin krijues në zhanre të ndryshme dhe shprehje artistike në fushën e muzikës, teatrit, filmit, arteve vizuale, si dhe nëpërmjet performansave multimediale, nga të cilat shumica zhvillohen në ambiente

të hapura të qytetit nën qiellin e kthjellët. Duke u nisur nga përcaktimi i shtetit tonë dhe kryeqytetit tonë përzvillimin e kulturës sipas terkut europian, në programin e „Vera e Shkupit“ do të marrin pjesë një numër i madh ansamblesh, koresh, orkestrash dhe krijuesish të arteve vizuale nga Sofja, Nishi, Beogradi, nga qytetet e vëllazëruara Nyrenberg dhe Drezden, pastaj nga Këlni, Zagrebi, Hungaria, Spanja, Australia, si dhe nga vende të tjera europiane. Ajo që është akoma më e njohur për „Vera e Shkupit“ është fakti se prezanton kryeqytetin tonë si ambient urban me traditë të pasur kulturore dhe artistike, dhe gjithsesi, si qendër me ofertë intensive të denjë për interes dhe kujdes nga konsumuesit më të përzgjedhur të artit – theksoi kryetari Koce Trajanovski, në hapjen e këtij manifestimi prestigjioz.

Para koncertit, në suazat e programit „Vera e hapur 2012“, në Qendrën kulturore informative u hap Ekspozita ndërkombëtare e skicave „Lidhje-Shkup-Nish-Sofje“. Ekspozita përfshin vepra të 15 artistëve nga Maqedonia, Serbia dhe Bullgaria, më saktë nga pesë pjesëmarrës nga çdo vend. Ashtu siç tregon edhe vetë titulli, tema ka të bëjë me lidhjen e artistëve të tre vendeve, kurse projekti parashikohet të transformohet në një manifestim tradicional në të ardhmen.

Sponsorë të manifestimit „Vera e Shkupit 2012“ tradicionalisht janë Qyteti i Shkupit dhe Ministria e kulturës e Republikës së Maqedonisë, organizator dhe realizues i programit është Drejtoria për kulturë dhe art - Shkup, kurse festivali zgjat deri më 31 korrik. Qyteti i Shkupit për mbajtjen e këtij manifestimi ndau dy milion denarë.



QYTETI I SHKUPIT HAPI GALERINË "JUSTINA DHE RODOLJUB ANASTASOV"

Galeria „Justina dhe Rodoljub Anastasov“, në Muzeun e Qytetit të Shkupit, më 30 maj hapi dyert për adhuruesit e artit.

- Me respekt të veçantë dhe mirënjohje të madhe i drejtohem autorit Rodoljub Anastasov për gjestin e madh human të tij për të ndërmarrë një punë jo të zakonshme, por pa dyshim shumë të rëndësishme, për t'ia lënë një pjesë të krijimtarisë së tij cilësore Muzeut të qytetit të Shkupit. Përmbledhja e 398 veprave përbën një opus unik në suazat e krijimtarisë së përgjithshme të autorit, i cili është një autor i njohur dhe me renome jo vetëm në Maqedoni por edhe më gjerë dhe doajen e artit figurativ maqedonas, pedagog dhe profesor. Të gjitha veprat e autorit, të

cilat janë me vlerë të jashtëzakonshme të përhershme do të mbeten në vargun e artit figurativ bashkëkohor maqedonas, kurse ky legat me vlerë, kjo përmbledhje mundësoi edhe formimin e galerisë në të cilën do të ruhet kujtimi për autorin dhe veprën e tij si udhërrëfyes për gjeneratat e ardhshme – tha kryetari Koce Trajanovski, në hapjen e galerisë.

Përmbledhja të cilën e dhuroi piktori akademik Anastasov përbëhet nga skica, pastel, akuarel dhe vepra të punuara në teknikë të kombinuar dhe vaj në pëlthurë, të punuara në periudhën nga viti 1957 deri në vitin 2010. Me rastin e donacionit Rodoljub Anastasov, Muzeu në bashkëpunim me Qytetin e Shkupit



dhe Ministria e kulturës e Republikës së Maqedonisë, mundësuan përkrahje materiale për hapjen e galerisë e cila do të mbajë emrin e tij dhe të bashkëshortes.



Shkrimtari maqedonas Sande Stojčevski dhe poeti bullgar Petar Karaargov janë laureatët e sivjetmë dhe fitues të Çmimit „Skeptër i letërsisë“ i manifestimit tradicional të poezisë „Festa e blirëve 2012“, i

„FESTA E BLIRËVE 2012“

cili u mbajt më 12 qershor.

Në manifestim u lexua vjersha „Bliri“ nga Mateja Matevski, me të cilën fillon tradicionalisht „Festa e blirëve“, kurse u prezantuan edhe librat e poezisë nga të dy autorët fitues të çmi-

mit „Skeptër i letërsisë“, që me këtë rast u përkthyen në disa gjuhë të huaja. U promovua edhe botimi i ri revistës „Stozher“ që iu kushtohet fituesve të skeptrit, kurse laureati nga Republika e Bullgarisë u shpall qytetar nderi i Shkupit.

Si pjesë e këtij manifestimi u mbajt edhe mitingu poetik, në të cilin me krijimet e tyre poetike u prezantuan 25 poetë maqedonas.



EDICION I PARË I SUKSESSHËM I „SHKUPI KREATIVA“ 2012



Tridhjetë pjesëmarrës, krijues nga fusha e teknologjisë IT, dizajnit të modës, filmit, teatrit, muzikës dhe letërsisë ishin pjesë e programit të pasur në edicionin e parë të festivalit për industri kreative „SHKUPI KREATIVA“, që u mbajt nga data 14 deri më 16 qershor në pjesën e parë të Parkut të qytetit, nën kujdestarinë e Qytetit të Shkupit. Konstruksioni atraktiv arkitektonik i ashtuquajtur „IGLO“ nën drejtimin e studios arkitektonike „Platforma“, ishte rast i mjaftueshëm për mijëra dashamirës nga Shkupi dhe nga Maqedonia të jenë të pranishëm në tre ditët e festivalit dhe të kënaqen me krijimet e shkëlqyera të artistëve tanë të rinj, por edhe kompani me eksperiencë botërore.

Fillimi i festivalit ishte më 14 qershor me hapjen e konferencës së parë ndërkombëtare me titull „Industri kreative-teori e shndërruar në praktikë“. Publiku kishte mundësi të „përballej“ me punën e studios maqedonase për animim „FxZx“ e cila bashkëpunon me produksione prestigjioze në Hollivud, të shikojë figurën e parë të animuar „Makedon“, por edhe të njihet me zgjidhjet softuerike „Intelligent network solution“ dhe „Codewell“. Në punëtori u krijuan prodhime të reja si: film i animuar, prodhim i „Animaks studio“ nga Shkupi, pastaj shtrat dhe tavolinë nga mbeturina industriale dhe ambalazh nga post-të diplomuarit e Akademisë së arteve figurative dhe „Pakomak“, si dhe CD me muzikë të re, nga punëtorja e Toni Dimitrov dhe Sashe Puckovski.

Publiku kishte mundësi t'i shikojë krijimet e mobilieve të dizajnuara me stil

modern të Viktorija Langoska dhe dizajnët ekskluzive të kompanisë „PUNKT MEDEL“. U prezantuan edhe trupat ngrohës të dizajnuara nga kompania maqedonase „ZAVAR“, si dhe dizajni i modës i konceptuar i „LUDUS“, Fashion week Shkup dhe tavolina interaktive e Rosica Mrshiq dhe Zoran Runçev Runo.

Si pjesë e programit të festivalit u prezantua edhe studentja e Universitetit të Europës Kristina Georgievka, e cila ofroi zgjidhje të reja vizionare për qytetin

e Shkupit. Në të njëjtën kohë, Kristina Georgievka është fituese e çmimit për zgjidhjen më të mirë ideore për logon e festivalit „SHKUPI KREATIVA“.

Një grup studentësh të Fakultetit arkitektonik nga Shkupi, në suazat e festivalit plotësuan hapësirën tek restoranti i mirënjohur i mëparshëm „Ezerce“, duke krijuar për një moment një hapësirë të re urbane, e cila ishte një hit i vërtetë i edicionit të sivjetmë „SHKUPI KREATIVA“.



**për rrugë automobilistike më të mira
për qarkullim rrugor më të sigurt
për qarkullim rrugor pa ndërprerje
për Shkupin tonë**



AKTIVITETE NDËRTIMORE PËR ZGJERIMIN DHE RIKONSTRUKSIONIN E RRUGËVE DHE BULEVARDEVE

1. Zgjerimi dhe rikonstrukcioni i rrugës "Prvomajska"
2. Zgjerimi dhe rikonstrukcioni i bulevardit "Sveti Kliment Ohridski"
3. Ndërtimi i unazës ndërmjet bulevardëve "Partizanski odredi" dhe "Makedonska vojska" dhe rrugëve "4-Juli" dhe "Luka Gerov"
4. Ndërtimi i unazës në rrugën "Boca Ivanova" (në Butel)
5. Ndërtimi unazës në rrugët "Llazo Trpovski" dhe "2. Makedonska brigada"
6. Zgjerimi dhe rikonstrukcioni i bulevardit "Mitropolit Teodosij Gologanov" – faza e dytë
7. Zgjerimi dhe rikonstrukcioni i bulevardit "Ilinden" – faza e tretë
8. Ndërtimi i bulevardit Manapo
9. Rikonstrukcioni i rrugës "Kozle" – pjesa e dytë
10. Rikonstrukcioni i rrugës "Radishanska" – pjesa e dytë
11. Rikonstrukcioni bulevardit "Jane Sandanski"
12. Rikonstrukcioni i rrugës "Samoilova"
13. Rikonstrukcioni i rrugës "Bllagoja Stefkovski" – faza e dytë



QYTETI I SHKUPIT